



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
NJËSIA E PROKURIMIT**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS T. KOÇELI” (Pershtatje per zyra)

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): - Punime
ndërtimi**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 51,214,807 lekë (pesëdhjet e një milion dyqind e katërbëdhjet mijë e tetëqind
e shtatë) Lekë Pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Selenice ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteri (a) është vendosur në bazë të nenit 82 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri (b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 83 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- NP – 1 A Punime gërmimi në tokë;
- NP – 2 B Ndërtime civile dhe industriale
- NP – 3 B Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

Për punimet speciale të ndërtimit:

- NS – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS – 2 A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre
- NS – 4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik , metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- NS – 12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- NS – 14 B Impiante të brëndëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- NS – 18 A Punime topogjeodezike

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku jane te percaktuar kategorite perkatese dhe niveli i klasifikimit per licensat e subjekteve qe ushtrojn veprimtari ne fushen e ndertimit.

Pikat e licensave jane percaktuar ne baze te zerave te pershkruara ne preventivin e projektit. Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Punime gërmim dheu	A	0-20 milion
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	Punime të mirëmbajtjes dhe rikonstruksionit të objektit të shkolles (pershtatje për zyra)	B	21-50 milion
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale,	Punime për rikonstruksionin e objektit	B	21-50 milion

	<i>veshje fasadash</i>			
NS-1	<i>Punime per prishjen e ndertimeve</i>	<i>Prishje mure, soleta, shtresa, suvatime, davancale, etj.</i>	A	0-20 milion
NS-2	<i>Impiante hidro- termosanitare dhe mirembajtja e tyre</i>	<i>Punime Hidro-Sanitare</i>	A	0-20 milion
NS-4	<i>Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese</i>	<i>Ndertim mur tulle, suvatime, patinime, lyerje, veshje fasade me kapot, punime grafiato etj</i>	B	21-50 milion
NS-12	<i>Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit</i>	<i>Sistemi i ngrohjes</i>	A	0-20 milion
NS-14	<i>Impiante te brendshme elektrike telefoni radiotelefoni TV</i>	<i>Rrjeti i brendshem elektrik dhe telefonise</i>	B	21-50 milion
NS-18	<i>Punime topogjeodezike.</i>	<i>Punimet per ndertimin e dhe pozicionimin e ambjenteve te reja paraqesin nevojen e punimeve topogjodezike</i>	A	0-20 milion

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme të lëshuara nga ente kombetare ose nderkombetare të akredituara, të përcaktuara si më poshtë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)
- Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor ISO 14001-2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- Certifikat e menaxhimit të energjisë ISO 45001:2018 (**Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë**) ose **ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën

për t'u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar ”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo certifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.
- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015 , standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një menaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.
- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare **2021-2022 dhe 2023** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % i vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021-2022 dhe 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet të njëpasnjëshme, nuk ka raport

negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.i cili parashikon se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2024** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument në momentin e dorëzimit të dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2023, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, për sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

2.3.4 Kontroll në kantier nga ana e autoritetit kontraktor.

Autoriteti kontraktor kur e shikon të arsyeshme përpara shpalljes të njoftimit fituesit paraprak ben vizite në kantier për të verifikuar kapacitetet teknike nëse këto kapacitete janë të disponueshme vetëm për realizimin e kësaj kontrate. Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ose nëse AK e shikon nevojën për të kërkuar sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

a. Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:

- Formulari i vlerësimit
- Kontratë punimesh;
- Situacion përfundimtar;
- Akt-kolaudimi;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b. Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:

- Formulari i vlerësimit
- Kontratën e punimeve,
- situacionin përfundimtar,
- aktin e kolaudimit, (ne rastet kur ky dokumentacion leshohet)
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- faturën tatimore te Situacionit perfundimtar.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:
- Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar jo më pak se 45 (dyzet e pese) për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024, ku Stafi Teknik të jete me kohe të plote pune për periudhën e fundit **3 (tre)** mujore (*Korrik-Gusht-Shtator 2024*) të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024.
- b) List pagesat e punonjësve me kohe të plote konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohe nga legjislativi në fuqi për periudhën Korrik 2024 – Shtator 2024

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, nenit 77, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, Pika 6/ç, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqi minimale puntore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin e fuqisë puntore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit teknik të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.”. Në këtë kontekst autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit orëve të punës (8 orë në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë puntore janë përllogaritur stafi teknik dhe inxhinjerik si dhe stafi administrativ. Nga përllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhet 45 (dyzet e pese) punonjës me kohe të plote.

Nr.	Nr. An.	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Ore pune punetori	Ore totale	Ore pune maki neri	Ore totale
						38,164.96		1,541.53
1	2.391	Heqje dyer ekzistuese	m2	90.37	1.2	108.444		0
2	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	m2	42.8	2.4	102.72		0
3	2.395/2 a	Dyer d/alumini dopio xham	m2	30	2	60		0
4	2.386/2	Dyer te blinduara	m2	2.8	4.574	12.8072		0
5	2.373/ a	Vetrato xhami i temperuar	m2	160.1	1.3	208.13		0
6	2.394/2 a	Grila d/alumini me role per dritare.	m2	52.88	2.5	132.2		0
7	2.375	Dritare d/alumini tek xham	m2	10.08	2.2	22.176		0
8	2.375/2 a	Dritare d/alumini dyfi xh.	m2	182.17	2.2	400.774		0
9	2.426/1 1	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	3459.68	0.93	3217.5024		0
10	2.426	Prishje mur tulle pa pastrim	m3	17.04	2.2	37.488		0
11	2.212/ a	Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm	ml	173	0.79	136.67		0
12	2.209/ a	Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120	ml	46.8	0.545	25.506		0
13	2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	copë	6	2.42	14.52		0
14	2.218	Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla vendi	m2	957	2.7	2583.9	0.02	19.14
15	2.195	Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum	m2	140.704	0.42	59.09568		0
16	2.267/ a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m2	1240.5	1.66	2059.23	0.07	86.835
17	2.289	Trotuar me lluster çimento, pa borduren e betonit	m2	26.62	1.8	47.916		0
18	2.276/ a	Shtrese parketi laminat	m2	88.8	0.365	32.412	0.53	47.064
19	2.288	Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit	m2	1367.78	2.4	3282.672		0
20	2.291	Bordura trotuari 25x12cm derdhur ne vend	ml	87.05	1.2	104.46		0
21	2.273/5	Shtrese me pllaka mermeri t=3cm	m2	39.36	3.12	122.8032	0.02	0.7872
22	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	124.786	2.9	361.8794		0
23	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	18.26	8.6	157.036	0.73	13.3298
24	2.283	Shtrese stirobetoni	m3	93.01	5.79	538.5279		0
25	2.31	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m2			0	0.018	0
26	2.358/ b	Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.	m2	1507.18	5.8	8741.644	0.53	798.8054
27	2.297/ a	Veshje tavani me kartonxhes	m2	147.7	2.1	310.17		0
28	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m2	3378.55	0.76	2567.698		0
29	2.34	Suva xokoli me granil e çimento te bardhe.	m2	290.15	3.5	1015.525	0.16	46.424
30	2.326	Veshje me pllake majolike	m2	307.36	3.7	1137.232		0
31	2.300/1	Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe	m2	1040.13	0.005	5.20065	0.17	176.8221
32	2.34	Suva xokoli me granil e çimento te bardhe.	m2	70.36	3.5	246.26	0.16	11.2576
33	2.414	F.V zgara dekorative hekuri me konfiguracion mesatar	ton	0.3	54.6	16.38		0
34	2.401	Boje vaji siperfaqe metalik	m2	140	1.47	205.8		0
35	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	5018.7	0.36	1806.732		0
36	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	290.15	0.36	104.454		0
37	3.643	Mbjellje bari ne skarpat	m2	340	0.17	57.8		0
38	3.961	F.V. Fidane Peme dekorative	copë	8	1	8		0

39	3.377	Ndertim drenazhi, mbushje me gure lumi	m3	40	4.1	164		0
40	3.406	F V tub drenazhi Ø 150 mm	ml	60	0.9	54		0
41	3.391	F V tuba plastmasi per vaditje, Ø 32 mm	m	55	0.22	12.1		0
42	3.401/1	Gjeotekstil me gramature 280 g/m2	m2	85	0.09	7.65		0
43	2.575	Puse kontrolli 1x1x1.5m	copë	1	50.3	50.3		0
44	2.341	Pusete shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak gize	copë	13	4.2	54.6		0
45	2.575	Puse kontrolli 1x1x1.5m	copë	1	4.2	4.2	1.1	1.1
46	2.54	Tuba gize me plumb / 2	kg	250.02	0.037	9.25074		0
47	3.164/1 t	F V tuba te brinjzuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	12	1.5	18		0
48	3.182	FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm	copë	3	0.4	1.2		0
49	3.17	F V pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	copë	2	3.8	7.6		0
50	3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25	m3	97.6	12.9	1259.04	2.29	223.504
51	3.247	Struktura monolite betoni me çakell C 25/30	m3	27.6	12.9	356.04	2.29	63.204
52	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	6.5	60	390	0.63	4.095
53	2.166/1 a	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	9.5	42	399	0.63	5.985
54	2.501	F.V WC allafrenga	copë	12	3.7	44.4		0
55	2.495	F.V lavaman porcelani	copë	4	2.95	11.8		0
56	2.491/2 a	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=20mm, t = 2.0 mm, Pn 10	ml	132.09	0.25	33.0225		0
57	2.515	F.V pilete dyshemeje Ø 50	copë	6	1.7	10.2		0
58	2.494/1	F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm	copë	12	1.2	14.4		0
59	2.494/2	F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm	copë	8	1.2	9.6		0
60	2.52	F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110	ml	78	1.43	111.54		0
61	2.477	F.V Tuba PVC Ø 315 mm per linja te jashtme	ml	133.68	0.35	46.788		0
62	2.51	F.V hidrante Ø 50 mm	copë	2	5.1	10.2		0
63	2.488	F V rezervuari zingato 5000 litra	copë	1	9	9	1.5	1.5
64	2.491/2 e	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, t = 3.7 mm, Pn 10	ml	44	0.25	11		0
65	2.521	F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 140	ml	53	1.66	87.98		0
66	2.508	F.V bolier 100 l	copë	2	2.1	4.2		0
67	2.529	F.V. Çeles me dy pozicione, I-0-2 380V,20A	copë	50	1	50		0
68	2.490/f	F.V Kasete plastike KE me 36 modular (vende)	copë	4	4.9	19.6		0
69	2.535	F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A	copë	1	0.5	0.5		0
70	2.561	F.V. Llampe sinjalizimi 220V;1.2w	copë	2	0.1	0.2		0
71	2.487	F.V Kutiderivacioni plastr	copë	80	0.33	26.4		0
72	2.487/ a	F.V kuti suport pllaket 2 mod	copë	62	0.25	15.5		0
73	2.487/ b	F.V kuti suport pllaket 4 mod	copë	60	0.25	15		0
74	2.485/ d	F.V priza shuko universal	copë	250	1	250		0
75	2.485/ b	F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T	copë	120	0.9	108		0
76	2.485	F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim	copë	130	1	130		0
77	2.480/2	F.V tub plastmasi Ø 18-21mm	ml	536.49	0.32	171.6768		0
78	2.461	F.V. Ndricues fluoreshent 2x36w,IP40	copë	3	1.5	4.5		0
79	2.458	F.V. Ndricues fluoreshent 1x40w.IP65	copë	179	0.8	143.2		0
80	2.473	F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40	copë	3	1.3	3.9		0
81	2.465	F.V. Ndricues tip plafoniere, emergjence,1x18w,IP65	copë	2	1.2	2.4		0

82	2.535	F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A	copë	2	0.5	1		0
83	4.150/6	F.V. percjellesa Cu te izoluar me gome, per ndricim,ne izolator, sexion 10mm2	km	0.853	155	132.215		0
84	4.150/4	F.V. percjellesa Cu te izoluar me gome, per ndricim,ne izolator, sexion 4mm2	km	0.78	100	78		0
85	4.150/3	F.V. percjellesa Cu te izoluar me gome, per ndricim,ne izolator, sexion 2.5mm2	km	0.571	100	57.1		0
86	4.150/2	F.V. percjellesa Cu te izoluar me gome, per ndricim,ne izolator, sexion 1.5mm2	km	0.75	100	75		0
87	4.131/3 .7	F.V.ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesa plastmasi, te armuar, 4x25mm2	m	52	0.45	23.4		0
88	2.108/1 a	Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa	m2	163.63	3.59	587.4317	0.02	3.2726
89	2.70/2	Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25	m3	13.34	15.7	209.438	0.55	7.337
90	2.71/1	Mur me tulla te lehtesuara dopio deri 8 m, LL.P. M-15	m3	30.48	18.6	566.928	0.81	24.6888
91	2.29	Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne toke	m3	227.79		0	0.028	6.37812
92	An1	Prishje pllaka cimentoje	m2	1484.3	1.0388	1541.89084		0
93	An2	Prishje e rrjetit elektrik egzistues	komplet	1	346.2591	346.2591		0
94	An3	F V dyer te brendeshme TAMBURATO	m2	32.7	0.5	16.35		0
95	An4	F.V. Parmake metalizato ne shkalle	ton	0.3	20.5	6.15		0
96	An12	Bilbila te fshehte per vaditje lulishte	copë	13	0.4	5.2		0
97	An13	F.V e shtyllave ndricimi dekorative , me lartesi h = 7 m d=160mm,	copë	10	1.1	11		0
98	An14	F.V ndricues dekorative LED 75 wat per ambiente te jashtme	copë	7	0.5	3.5		0
99	An15	F.V te kuadrit elektrik me automat mgt 4p 32A, automat diferencial 4p 40A 5d=0,3A, 4 automatë mgt 1p 16A 16kA, 4 kontaktorë modular 4p 40A, 4 çelësa seksionues 1p 16A	copë	2	3.2	6.4		0
100	An16	Tub fleksibel Ø 64 mm	ml	109	0.1	10.9		0
101	An17	Kabell FGOR 3x2.5mm	ml	109	0.1	10.9		0
102	An18	Kabell FGOR 3x6mm	ml	109	0.1	10.9		0
103	An20	F.v Stola te Thjeshte	copë	3	0.71	2.13		0
104	An10	Ti me presim 20x16x20	copë	18	0.2	3.6		0
105	An11	Ti me presim 20x20x16	copë	16	0.2	3.2		0
106	An19	Ti me presim 20x16x16	copë	13	0.2	2.6		0
107	An21	Valvol shfryrese bronxi 1/2"	copë	8	0.2	1.6		0
108	An22	Guaine 54x9 (46m)	copë	4	0.1	0.4		0
109	An23	Guaine 64x9 (40m)	copë	20	0.1	2		0
110	An24	Priza telefoni RJ 11-TF	copë	65	0.2	13		0
111	An25	Priza internet RJ 45 (Data)	copë	66	0.2	13.2		0
112	An26	Swicher(shperndares sinj. Internet)	copë	8	0.2	1.6		0
113	An27	Ruter	copë	4	0.5	2		0
114	An28	Tubo P.V.C. fleksibel ø63	copë	950	0.1	95		0
115	An29	Kabell P.V.C. 3x1.5 mm²	ml	420	0.1	42		0
116	An30	Kabell internet U.T.P .4(2x0.5)	ml	650	0.1	65		0
117	An31	Kabell telefoni 2(2x0.5)	ml	124.78	0.1	12.478		0
118	An33	Shkeputes rrjeti	copë	2	0.3	0.6		0
119	An34	F.V.Tabele sinjalistike - Hidrant Zjarri	copë	2	0.4	0.8		0
120	An35	F.V.Tabele sinjalistike - Fikse zjarri me pluhur 6 kg	copë	5	0.2	1		0
121	An36	F.V.Tabele sinjalistike - Buton alarmi	copë	3	0.2	0.6		0

122	An37	F.V.Tabele sinjalistike - Drejtim I daljes se emergjences	copë	7	0.2	1.4		0
123	An38	F. V Kasete per hidrantin me aksesore	copë	2	0.8	1.6		0
124	An39	Detektor tymi	copë	36	0.3	10.8		0
125	An9	Fikëse zjarri pudër ABC, 40%, 6 kg	copë	5	0.23	1.15		0
126	An40	Korimano xhami	ml	28.2	0.12354	3.483828		0
127	Pj	F.V Pompe uji 1.12kW+aksesor	copë	2		0		0
128	Pj	F.V Kondicioner, Fuego, 12000 BTU, Inverter, A++/A+, WiFi iOS - Android, 50 dB, 84×31.5×26 cm+aksesor	copë	20		0		0

Totali ore pune puntori **38,164.96** / (8x22x5) = 43.37

Totali ore pune puntori per makinerit **1,541.53** / (8x22x5) = 1.75

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje 3 (tre) muajt e fundit tregojnë besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.4

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik të përfshirë në licensën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për perjudhen Korrik 2024 - Shtator 2024.

Stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi Strukturor
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeomatik (Topograf)
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri si dhe te figuroje ne liste pagesat e shoqerise me kohe te plote ose ne rast BOE te jene te punesuar per perjudhen Dhjetor 2023- Mars 2024

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

•Arkitekt 1(një)

Kerkohet Arkitekt pasi kemi te bejme me rikonstruksion total te objektit. Referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen punime, te cilat kerkojne detyrimisht mbikqyrjen nga arkitekti gjate gjithe periudhes te zbatimit te punimeve.

•Inxhinier Ndërtimi Strukturor 1(një)

Kerkohet Inxhinieri i ndertimit strukturor pasi kemi te bejme me rikonstruksion total te objektit si dhe ndertim te objektit te ri. Referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen punime, te cilat kerkojne detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri i ndertimit strukturor gjate gjithe periudhes te zbatimit te punimeve.

•Inxhinier Ndërtimi 1(një)

Kerkohet Inxhinieri i ndertimit pasi kemi te bejme me rikonstruksion total te objektit. Referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen punime, te cilat kerkojne detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri i ndertimit gjate gjithe periudhes te zbatimit te punimeve.

•Inxhinier Elektrik 1(një)

Kerkohet inxhinieri elektrik, pasi referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen instalime elektrike, do te kemi ndryshime linjash elektrike dhe ndryshim ndriçimi ne te gjitha ambientet, te cilat kerkojne detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri elektrik gjate gjithe periudhes te zbatimit te punimeve.

•Inxhinier Mekanik 1(një)

Kerkohet inxhinieri mekanik, pasi referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen punime te sistemit ngohje-ftohje, radioret punime te strukturave metalike neper strehat e objektit. E kemi kerkuar kete inxhinier per arsye se mund te kete problematikagjate zbatimit te punimeve dhe mund te kete ndryshime dhe rregullime te cilave mund ti pergjigje gjate zbatimit inxhinieri perkates. Si dhe eshte e domosdoshme asistenca e inxhinierit per çdo defekt te mundshem te mjeteve qe do te perdoren gjate zbatimit te punimeve.

• inxhinier Gjeomatik (topograf) 1(një)

Kerkohet 1 inxhinier ndertimi profil gjeodet (topograf) i cilet do te zbatojne punimet lidhur me piketimin e ndertimit te ri si dhe ndertimet te cilat do te kryhen per sistemimin e oborrit.

- inxhinier elektronik 1(një)

Kerkohe 1 inxhinier elektronik si staf mbeshtetes per zbatimin e punimeve elektronike qe kane te bejne me shperndarjen e linjes telefonike si dhe linjes se internetit.

- Inxhinier Hidroteknik 1(një)

Kerkohe inxhinieri hidroteknik, pasi referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen punime te sistemit hidroteknik. E kemi kerkuar kete inxhinier per arsye se mund te kete problematikagjate zbatimit te punimeve dhe mund te kete ndryshime dhe rregullime te cilave mund ti pergjigje gjate zbatimit inxhinieri perkates. Si dhe eshte e domosdoshme asistenca e inxhinierit per çdo defekt te mundshem te mjeteve qe do te perdoren gjate zbatimit te punimeve.

b) Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtues teknik ne profilin Inxhinier ndertimi strukturist, i specializuar ne fushen qe ka te beje me reagimin sizmik te stukturave civile dhe infrastrukurore sipas rregullave kombetare e nderkombetare. Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).

Argumentimi: Autoriteti kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specififikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga

jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dëpsozitate ligjore në fuqi.

c) Operatorët ekonomikë për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë;

- 2 (dy) Teknik i mesem ndertimi
- 1(nje) Teknik Mekanik
- 2 (dy) Elektracist
- 1 (një) Specialist IT
- 2 (dy) Punonjes Duralumini
- 2 (dy) Hekurkthyes
- 1 (një) Hidraulik
- 2 (dy) Puntor te thjeshte
- 2 (dy) Murator
- 2 (dy) Hidroizolues
- 2 (dy) Karpentier
- 3 (tre) Suvatues
- 3 (tre) Pllakashtrues
- 2(dy) Saldator
- 2(dy) Bojaxhi

* Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje dokumentacionin qe verteton profesionin si :

- Kontratat e punes individuale te vlefshme
- Per stafin e mesiperm, Deshmia e kualifikimit/ certifikate dhe/ose diploma e cila te jete e leshuar nga Ministria e Financave ose te njihet nga Ministria e Punes Ceshtjeve Sociale te paraqitet certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat / diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.*”, i ndryshuar. Kjo kerkese po ashtu eshte ne perputhje me vendimin nr. 441/2020, date 09.10.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik. Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma te cilat nuk jane te licensuara sipas legjislacionit ne fuqi do te konsiderohen si dokumenta te rreme te cilat perbejne shkak per skualifikim dhe/ose perjashtimin e ketij kontraktori nga pjesemarrja ne prokurimet publike.
- Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise
- **Diplome** nga institucionet e arsimit te mesem profesional(publik/privat) te akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne RSH*”, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroje ne listepagesa.
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marredhënieve të punës	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data e vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	---	---	------------------------------------	--

Kriteri konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-se, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertës, të dorezuara në rrugë elektronike. Keto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njesuara me origjinalin”**.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik i mesem Ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punimeve në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Teknik Mekani** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të sistemit të impianteve ngrohëse-ftohëse për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve të nr. analizës pj. .
- **Elektricitet** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve të nr. analizës 2.529,2.490/f, 2.535, 2.561, 2.487, 2.487/a, 2.487/b, 2.485/d, 2.485/b, 2.480/2, 2.461, 2.473, 2.465, 2.535 etj.
- **Murator** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve të nr. analizës 2.108/1a, 2.70/2, 2.71/1.
- **Saldator** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve në nr. e analizës 2.166 dhe 2.166/1a.
- **Karpentier** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve në nr. e analizës 2.262/4.
- **Punonjes duralumini** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve në nr. e analizës 2.395/a, 2.395/2a, 2.386/2, 2.373/a 2.394/2a, 2.375 dhe 2.375/2a.
- **Hekurthyes** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është

i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve në nr. e analizës 2.262/4.

- **Hidraulik** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve në nr. e analizës 2.501, 2.495,2.491/2a, 2.515, 2.494/1, 2.494/2, 2.520, 2.477, 2.510, 2.488, 2.491/2e dhe 2.521.
- **Hidroizolues** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve në nr. e analizës 2.358/b.
- **Suvatues** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve në nr. e analizës 2.310, 2.340 dhe 2.300/1.
- **Pllakashtrues** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve në nr. e analizës 2.267/a, 2.273/5.
- **Bojaxhi** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve në nr. e analizës 2.401, 2.40/1.
- **Specialist IT** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve të linjes se internetit.
- **Puntor te thjeshte** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve te ndryshme.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij te punesuar 1 (nje) ekspert “Per Vlersimin e ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor” të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per perjudhen Dhjetor 2023- Mars 2024, me kontrate pune, diploma, stafin mbështetës si më poshtë:

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohët vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Qëllimi për vendosjen e këtij kriteri është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve. Vlerësimin e ndikimeve negative mjedisore në kohën e duhur dhe parandalimin e tyre.

Duke qënë se punimet do të kryhen pandërprerë aktivitetin e përditshëm të punës dhe në prani të shumë personave afër dhe Brenda kantierit të ndërtimit dhe duke pasur parasysh vendin e ndërtimit, është parë e nevojshme disponimi I ekspertit të ndikimit në mjedis. Në pikën 4, Nenin 24 të ligjit Nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis” përcaktohet se liçencat e këtyre ekspertëve përfshihen në kategorinë III.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor.

2.3.6. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhytjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në

punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit

Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit Nr:10 237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” ku citohet. “Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale nëndërmarrje/institucion”.

AK ka si qëllim të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë nga operatori ekonomik pjesëmarrës nëpërmjet pasjes së një stafi të kualifikuar për të nderhyrë në raste emergjence dhe dhenien e menjehershme të ndihmes së parë në raste aksidentesh. Për incidentet gjatë ndertimit të vepres është e nevojshme praninë e dy ekspertëve në të paktën dy fronte pune shkolla dhe palestra , të cilët do të monitorojnë proceset e punës për të parandaluar demtimin e punetoreve apo banoreve të zonës si dhe dhenien e ndihmes së parë. Në Nenin 27 të ligjit Nr.8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri" (i ndryshuar), , citohet: “Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në shfrytëzim e veprave dhe e objekteve të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor elektrik, ujësjellës-kanalizimeve etj.

Bëhen në përputhje edhe me kërkesat e këtij ligji, me normat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, me rregullat dhe normat ndërkombëtare teknike, si dhe me rregullat e përcaktuara në dispozita të veçanta” Referuar objektit të kësaj procedure prokurimi, si dhe bazuar mbi këtë legjislacion detyruar, në funksion të kontrollit të zbatimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit në ndërtimet e reja, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese është e nevojshme që operatori ekonomik të jetë i licencuar mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave pasi çdo vepër e përfunduar duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP), leshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- | | |
|----------------|---------|
| - Eskavatorist | 1 (një) |
| - Automakinist | 1 (një) |
| - Shofer | 2 (dy) |

(Në rastet kur mjetet/makinerite disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Per këte operatoret ekonomike duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vertetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Per kushtet, kriteret dhe programet për përparatjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhenien e Dëshmës së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinërive të renda për punime ndertime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdherin nr. 200, date 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjitikës.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8 te DST.

Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane autoritetit kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, ose nese do te jete nevoja per tu kerkuar sqarime nga AK.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për kater muajt e fundit.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm ngaoperatori ekonomik i shpallur fitues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqine minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit. Specialistet e mesipërm janë vendosur në përputhje me llojin e kontratës, analiza e zerave të punimeve dhe objektin që ndërtohet me një numër të mjaftueshëm për realizimin me sukses të punimeve. Duke pasur parasyhë numrin dhe llojin e makinerive që përkohet me orët e punës sipas zerave të analizës teknike, grafikun e punimeve është vendosur edhe numri i manovratorëve.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion/ kontrat sherbimi operatorit ekonomik.

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
	Makineri		
	Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 10 ton-15 ton)	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Eskavator me Zinxhir	1 cope	Në pronësi ose me qera
	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Autobetoniere	2 cope	Në pronësi ose me qera
	Autopompe betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Autovinc me Kosh	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Fabrike prodhimi te elementeve te betonit me QKL (pllake dhe bordura betoni)	1 copë	Në pronësi ose me qera/ Kontrate furnizimi noteriale
	Ekskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Fadromë me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Mini Eksavator me zinxhir	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Pirun Ngrites	1copë	Në pronësi ose me qera
	Pajisje		
	Elektrosaldatriçe	3 copë	Në pronësi ose me qera
	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Moto gjenerator	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Betoniere kantieri	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Nivelues Betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Pompe Suvatimi	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Vibrator Betoni	3 cope	Në pronësi ose me qera
	Skeleri	1600 m2	Në pronësi ose me qera
	Betoforma	300 m2	Në pronësi ose me qera

- **Pajisje të tjera ndihmëse, (të cilat duhet të vërtetohen me deklaratë sipas shtojces perkatese, të DST:**

Nr	Mjete mbrojtese	njesia	sasia
1	Kokore	copë	45
2	Jelek	copë	45
3	Tabela Sigurimi Teknik	copë	45
4	Kuti Ndhime e shpejt	copë	5
5	Prozhektor për ndricim	copë	5
6	Rripa lidhes sigurimi per punime ne lartesi	copë	5
7	Fikese zjarri te levizesme	copë	2

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi do të paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:
- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë);
- leje qarkullimi;

- d) çertifikate e kontrollit teknik;
- e) siguracion mjeti, (i vlefshëm);
- f) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet:
- g) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
- h) leje qarkullimi;
- i) çertifikaten e kontrollit teknik,
- j) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes . Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave të punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim .”

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomik mjetet dhe pajisjet teknike Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Percaktimi i makinerve është bere referuar zërave të punimeve reflektuar në tabelë sa më poshtë: Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe duke u bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore. Perkatësisht:

- Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton) u referohet analizave Nr. 2.391, 2.395/a, 2.395/2a, 2.386/2, 2.373/a, 2.394/2a, 2.375, 2.375/2a,2.426, 2.212/a, 2.209/a, 2.206, 2.276/a, 2.288, 2.291, 2.273/5, 2.258, 2.262/4, 2.283, 2.297/a, 2.328, 2.34, 2.326, 3.391, etj
- Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 10 ton-15 ton) u referohet analizave Nr. 2.391, 2.395/2a, 2.386/2, 2.373/a, 2.394/2a, 2.375, 2.375/2a,2.426, 2.212/a, 2.209/a, 2.206, 2.276/a, 2.288, 2.291, 2.273/5, 2.258, 2.262/4, 2.283, 2.297/a, 2.328, 2.34, 2.326, 3.391, etj
- Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton u referohet analizave Nr. 2.391, 2.395/a, 2.395/2a, 2.386/2, 2.373/a, 2.394/2a, 2.375, 2.375/2a,2.426, 2.212/a, 2.209/a, 2.276/a, 2.288, 2.291, 2.273/5, 2.258, 2.262/4, 2.283, 2.297/a, 2.328, 2.34, 2.326, 3.391, etj
- Eskavator me Zinxhir u referohet analizave Nr. 2.31, 2.29
- Autobot uji u referohet analizave Nr. 2.34, 2.300/1, 3.246, 3.247,
- Autobetoniere u referohet analizave Nr. 2.300/1, 3.246, 3.247,
- Autopompe betoni u referohet analizave Nr. 2.300/1, 3.246, 3.247,
- Autovinc me Kosh u referohet analizave Nr. 2.71/1, 2.70/2, 2.108/1a, 2.488, 2.501,2.166/1a, 2.166, 2.34, 2.262/4, etj

- Fabrike prodhimi te elementeve te betonit me QKL u referohet analizave Nr. 2.300/1, 3.246, 3.247
- Ekskavator me goma u referohet analizave Nr. 2.71/1, 2.70/2, 2.108/1a, 2.488, 2.501,2.166/1a, 2.166, 2.34, 2.262/4, etj
- Fadromë me goma u referohet analizave Nr. 2.71/1, 2.70/2, 2.108/1a, 2.488, 2.501,2.166/1a, 2.166, 2.34, 2.262/4, etj
- Mini Eksavator me zinxhir u referohet analizave Nr. 2.71/1, 2.70/2, 2.108/1a, 2.488, 2.501,2.166/1a, 2.166, 2.34, 2.262/4, etj

2.3.13 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- Pajisje hidrosanitare dhe hidraulike
- Pajisje elektrike
- Pajisje hidroizoluese dhe termoizoluese
- Bojë hidroplastike
- Tubo plastike
- Bordura dhe pllaka betoni

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- 1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar,** e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave.
- 2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001 (*Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë*)/ekuivalente dhe e vlefshme. Ndërsa për materialet tubo plastike dhe bordura betoni krahas ISO 9001 të paraqitet dhe Kodi III.1.B për prodhimin e plastikës dhe të bordura pllaka betoni

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, sipas deklaratës së mësipërme, brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për materialet e mesiperme AK vlereson si të domosdoshme që OE të provojë cilësinë e materialeve nga prodhuesi/distributori. Kërkesa është vlerësuar e nevojshme si kërkesë teknike pasi objekti që do ndërtohet është ndertese publike ku ka levizje dhe prani të shumte të njerezve dhe konsiderohet me rrezikshmeri të lartë. Për këto arsye materialet që do të perdoren në strukturën e kesaj godine duhet të jenë të garantuar sipas cilësisë

dhe standarteve te kerkuara, prandaj eshte e nevojshme qe AK te garantoje cilesine e ketyre materialeve.

2.3.14 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor **një mostër për:**

- Dritare d/alumini plastike me dopio xham
- Dyer te brendeshme druri.
- Pllaka

** Mostrat e paraqitura duhet të jenë prerje ku të evidentohen të gjitha elementet, detajet dhe aksesoret sipas specifikimeve teknike.*

- **Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje/material të kërkuar ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në DST, përbën kusht për s’kualifikim.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës

2.3.15 Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga Studio e projektimit e cila ka hartuar Projektin Objekt Prokurimi. Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 34 dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Në përfundim të punës grupi u referua në nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, pika

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave te punimeve bazuar në pikën 2, neni 19 i VKM – së Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, hartues të projekt – preventivit rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin

qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Afati i realizimit të punimeve është 5 (pesë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

2.3.16 Operatori ekonomik nuk duhet t'i ketë kapacitetet teknike të angazhuara në kontratat të tjera dhe nuk duhet të jenë të deklaruara në procedura të shpallura fituese (deklaratë me shkrim nga Administratori i Shoqërisë)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Personi përgjegjës:

Specifikimet teknike:

Fondi limit